

**VENDIM**  
**Nr. 272, datë 1.4.2015**

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2015, MIRATUAR PËR**  
**MINISTRINË E FINANCIVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 10, të ligjit nr. 160/2014, datë 27.11.2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Ministrisë së Financave, në buxhetin e miratuar për vitin 2015, t’i shtohet fondi prej 37 580 314 (tridhjetë e shtatë milionë e pesëqind e tetëdhjetë mijë e treqind e katërmbëdhjetë) lekësh, në programin 01110, “Planifikim, mena-xhim, administrim”, për shpenzime kapitale.
  2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2015.
  3. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Edi Rama**